

Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë (KMDK SH.A)

16.06.2023, Prishtinë

KOMUNIKATË E BORDIT TË PËRKOHSHËM TË DREJTORËVE TË KMDK SH.A

Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur sot, shqyrtoi gjendjen e krijuar në KMDK Sh.A dhe pasojat e saj në projektin "Menaxhimi i Mbeturinave të Ngurta II-IV" investim i KfW

Bazuar në kompetencat ligjore dhe detyrat mbikëqyrëse dhe fiduciare, Bordi i Drejtorëve të KMDK SH.A është i detyruar të kërkojë marrjen e masave ligjore kundër Kryeshefit Ekzekutiv të KMDK SH.A për shkak të shkeljeve ligjore, vazhdimi i mandatit të tij me afat të jashtëligjshëm, stagnim të zhvillimit të Kompanisë, vazhdimësi e menaxhimit mbijetues, mospërfillje të kërkesave dhe vendimeve të aksionarit, mospërmbushjes së detyrave të veta si KE, shkelje ligjore dhe mospërfillje të procedurave gjatë rekrutimit të stafit, dështimit për të siguruar qëndrueshmerinë financiare dhe operative. Rrezikoi projektin "Menaxhimi i Mbeturinave të Ngurta II-IV" në vlerë prej 53 milion euro i financuar nga Banka Zhvillimore e Republikës Federale të Gjermanisë "KfW" për shkak të dërgimit të informatave të gabuara dhe jo të plota për shpronësimin e pronave të paluajtshme që kërkohen për realizimin e projektit.

Sipas legjislacionit pozitiv përkatës, Bordi i Drejtorëve është përgjegjës për mbikëqyrjen rigorozë dhe të vazhdueshme të veprimtarisë së zyrtarëve të NP. Çdo drejtor i bordit, duke e përfshirë edhe kryeshefin ekzekutiv, duhet ti përmbush detyrat fiduciare të cilat përkufizohen si detyrë për të vepruar me ndershmërinë dhe besnikërinë më të lartë ndaj ndërmarrjes dhe në interesin më të mirë të saj. Duke pas parasysh që ndërmarrja është në pronësi publike, roli dhe detyrat kryesore të Bordit të ndërmarrjes, është të sigurojë që ajo të operon në mënyrë efikase edhe për interesat më të mira publike.

Duke parë rrethanat e krijuara ndër vite në KMDK SH.A, është parë e arsyeshme të bëhet auditimi dhe vlerësimi i gjendjes reale. Bazuar në gjetjet e Auditorit të Brendshëm, dhe raporteve të Zyrës Kombëtare të Auditimit, administrimin e provave tjera dhe gjendjes faktike, Bordi i Drejtorëve mori vendimin:

- I. Z. Abdullah Haxhiu, shkarkohet nga posti i Kryeshefit Ekzekutiv të KMDK SH.A
- II. Shfuqizohet vendimi i Bordit të Drejtorëve me nr.18/2019, i datës 18.10.2019
- III. Z. Abdullah Haxhiu obligohet ti dorëzoj asetet e KMDK-së që i ka në shfrytëzim të Drejtorit të Administratës
- IV. KMDK SH.A obligohet ta zbatoj këtë vendim
- V. Ky vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve të KMDK SH.A



Azja Mjeku
Kryesues i BPD i KMDK SH.A